



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 364/1 Prot.

Tiranë, më 24.02.2026

V E N D I M

Nr. 41, datë 24.02.2026

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 50 Regj., datë 17.02.2026, paraqitur nga z. E. B, kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “moshës”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar ankesës së depozituar pranë KMD-së, tek shpjegimi i fakteve për diskriminimin e pretenduar, subjekti ankues, E. B, i moshës 77 (gjashtëdhjetë e shtatë) vjeç³ pretendon se është diskriminuar nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Shkodër.

Lidhur me pretendimin për diskriminim nga ana e DRSSH Shkodër, ankuesi shpjegon si më poshtë vijon:

“Unë jam E. B, pensionist dhe paraqes ankesë, pasi nga Drejtoria Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Shkodër, më është caktuar pension i pjesshëm pleqërie me 27 vite periudhë sigurimi, me datë fillimi 12.04.2013, me masë fillestare 9.112 lekë/muaj dhe masë aktuale 14.447 lekë/muaj, ku në përllogaritje janë përfshirë periudhat:

- 21.09.1966 - 25.12.1967 (Stacioni Zooteknik Shkodër);
- 29.12.1967 - 10.12.1969 (Shërbimi Ushtarak);

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Me datëlindje 11.04.1948.

- 25.12.1969 - 31.12.1972 (Stacioni Zooteknik Shkodër);
- 23.01.1973 - 15.04.1976 dhe 22.04.1976 – 27.09.1976 (NNJHC Fierzë);
- 17.02.1977- 30.07.1992 (Ndërmarrja e Ushqimit Social dhe Ndërmarrja e Transportit e Tregtisë);
- 01.01.1993 – 30.09.1994 dhe 01.10.2012 – 12.04.2013, duke u llogaritur sipas nenit 32/3, të ligjit nr. 7703, por jam trajtuar si punonjës i kategorisë 3-të, ndërkohë që kam ushtruar funksion në kategorinë e 7-të, gjatë viteve tëpunës në Ndërmarrjen e Ushqimit Social dhe Transportit të Tregtisë, çka më ka sjell ulje të padrejtë të pensionit.

Po ashtu, Libreza e Punës mbahet pa të drejtë nga ISSH dhe nuk më është kthyer dhe pas kërkesave të mia të përsëritura, duke më penguar të mbroj në mënyrë efektive të drejtat e mia. Për këto arsye kërkoj hetimin administrativ të rastit, verifikimin e saktë të kategorisë së punës së ushtruar, rivlerësimin e pensionit bazuar në kategorinë e 7-të, korrigjimin e menjëhershëm të masës së pensionit me pagesën e diferencave të prapambetura dhe detyrimin e ISSH-së për kthimin e menjëhershëm të librezës së punës.”

Ankuesi kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit për shkak të moshës së tij, nga ana e DRSSH Shkodër.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 7 të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Nga shqyrtimi paraprak i parashkrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues pranë KMD-së, konstatohet se:

- Me Vendimin nr. 516, datë 30.06.2014, Dega e Përfitimeve/DRSSH Shkodër, i ka caktuar ankuesit pension të pjesshëm pleqërie, me 27 vite e 7 muaj periudhë sigurimi, me datë fillimi pagese 12.04.2013 dhe masë fillestare 9112 lekë/muaj. (Totali i të ardhurave ka rezultuar 11019 lekë/muaj).
- Masa aktuale e pensionit është 14447 lekë/muaj (Totali i të ardhurave ka rezultuar 17154 lekë/muaj).
- Në llogaritjen e pensionit janë përfshirë:
 - Periudha 21.09.1966 - 25.12.1967 (pranë Stacionit Zootechnik Shkodër);
 - Periudha 29.12.1967 - 10.12.1969 (periudhë kur ka kryer Shërbimin Ushtarak);
 - Periudha 25.12.1969 - 31.12.1972 (pranë Stacionit Zootechnik Shkodër);
 - Periudha 23.01.1973 - 15.04.1976 (pranë Ndërmarrjes së Ushqimit Social)
 - Periudha 22.04.1976 – 27.09.1976 (pranë NNJHC Fierzë);
 - Periudha 17.02.1977- 30.07.1992 (Ndërmarrja e Ushqimit Social dhe Ndërmarrja e Transportit e Tregtisë);
 - Periudha 01.01.1993 – 30.09.1994 (pranë subjektit “E. B”);
 - Periudha 01.10.2012 – 12.04.2013 (pranë subjektit “E. B”).
- Bazuar në përllogaritjen sa më sipër, ankuesit iu caktua pensioni i pjesshëm i pleqërisë në shumën 14447 lekë/muaj, për 27 vite e 7 muaj, periudhë pune të realizuar prej tij.
- Ankuesit i është bërë e ditur se, data e fillimit të pagesës është nga data 12.04.2013, si dhe i është bërë me dije, gjithashtu se, për pretendime të mëtejshme, konform nenit 86/1, të ligjit nr. 7703/1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSh”, të ndryshuar, ka të drejtën e ankimimit pranë Komisionit Rajonal të Ankimimit (KRA) Shkodër, brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni.
- Subjekti ankues nuk ka depozituar fakte e prova para KMD-së, që të ketë kundërshtuar administrativisht vendimin sipërcituar.

Bazuar në analizën e deklarimeve të depozituara nga subjekti ankues, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari: Sa i takon pretendimit të ankuesit se është diskriminuar nga DRSSH Shkodër, përse i takon përllogaritjes së gabuar të masës së pensionit të pjesshëm të pleqërisë, ai lidhet me periudhën kohore kur i është komunikuar atij dhe me momentin e njohjes me të.

Në këtë kontekst, subjekti ankues, lidhur me momentin kur ka ndodhur diskriminimi i pretenduar, ka shënjuar në formularin e ankesës vitin 2013. (që është viti i daljes së tij në pension të pjesshëm pleqërie).

Për rrjedhojë, Komisioneri vëren se, të gjitha pretendimet që burojnë nga veprimet e DRSSH Shkodër, lidhen pazgjidhshmërisht me periudhën kur ato supozohet se kanë ndodhur (vitin 2013), ose marrë dijeni (2014) dhe përse i takon të drejtës së kundërshtimit të tyre, ndiqet e drejta e ankimimit brenda afateve të caktuara ligjore.

Subjekti ankues ka pohuar se është vënë në dijeni të veprimeve diskriminuese të pretenduara, nga ana e DRSSH Shkodër, kundrejt personit të tij, në vitin 2014, kohë kur dhe i është njoftuar vendimi nr. 516, datë 30.06.2014, i DRSSH Shkodër.

Në kontekst të sa më sipër, subjekti ankues ka marrë dijëni lidhur me faktin se sa i është përlllogaritur masa e pensionit të tij të pjesshëm të pleqërisë, (*fakt për të cilin dhe pretendon diskriminimin*), dhe është njohur me aktet përkatëse, që në vitin 2014 (Vendimin e caktimit të masës së pensionit të pjesshëm të pleqërisë me nr. 516, datë 30.06.2014,) kur i është kommunikuar ankuesit. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 17.02.2026, pra më vonë se dy vite nga marrja dijëni.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, i cili citon se: “*Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijëni për sjelljen diskriminuese*”, ankesa e shtetasit E. B, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁴.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Së dyti: Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të moshës, nga ana e DRSSH Shkodër, sa i takon mospërfitimit në masën e duhur sipas tij të pensionit të pleqërisë, Komisioneri vëren se:

Në ankesën e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është pretenduar se trajtimi i tij i pabarabartë apo i pafavorshëm nga DRSSH Shkodër, ka ardhur për shkak të moshës së tij. Subjekti ankues, në rastin në fjalë është përfitues i pensionit të pleqërisë, sepse gëzon moshën e pensionit, aktualisht është 77 vjeç, por pretendin se përlllogaritja e tij është e gabuar dhe e pasaktë.

Fillimisht, Komisioneri vëren se, dokumentimi i shkakut për të cilin pretendohet diskriminimi është thelbësor në çështjen e provimit të tij, për të cilin ankuesi pretendon se ka ardhur si pasojë e posedimit të tij. *Mandej*, pasi ankuesi të ketë provuar se mbart shkakun e pretenduar, duhet që ai të sjellë indicie, fakte apo prova që të dokumentojë, se pikërisht bazuar në këtë shkak, moshën e tij, ai është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme nga DRSSH Shkodër.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri vlerëson, se *apriori* shkakun i pretenduar nga ankuesi, nuk mund të ketë shërbyer si shkak që mund të lidhet me trajtimin e tij të padrejtë apo të pafavorshëm, përse i takon mospërfitimit të pensionit të pleqërisë në masën e pretenduar prej tij, nga ana e DRSSH Shkodër, pasi është pikërisht gëzimi i këtij shkakun ligjor (i moshës së caktuar në ligj për përfitimin e pensionit) mbi të cilin ai përfiton pensionin e pleqërisë. Pra, e gjithë kategoria e pensionistëve, që përfitojnë pension pleqërie duhet detyrimisht ta gëzojnë këtë shkak/cilësi, të jenë të moshës të caktuar në ligj, për të përfituar atë. Mënyra e përlllogaritjes e caktimit të tij është diskrecion i këtyre organeve përgjegjëse, në analizim e vlerësim të dokumentacionit respektiv.

⁴ Për analogji citojmë vendimin nr. 33, datë 07.02.2022, vendimin nr. 22, datë 19.01.2024, të KMD-së.

Në raste të mosdakordësisë me vendimmarrjen e tyre, subjektit i lind e drejta e kërimit të korrigjimit e rillogaritjes së tij, fillimisht duke shteruar rekursin administrativ, e më pas atë gjyqësor, sipas përcaktimeve ligjore respektive.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes lidhur me këtë shkak.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse.....është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁵.

Së treti: Lidhur me pretendimet për masën e përlllogaritjes së pensionit të pjesshëm të pleqërisë, Komisioneri vëren se:

Në nenin 86 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 *“Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, lidhur me të drejtën e ankimit, parashikohet se:

“ 1. Ankimi kundër vendimeve të përfitimeve bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore; Ankimi në këto raste, depozitohet pranë sporteleve të shërbimit, në përputhje me legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel;

2. Ankimi kundër vendimeve të Komisionit të Ankimit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

3. Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në Gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar.....”.

Për sa më sipër, rezulton se pretendimi i ankuesit lidhet drejtpërdrejtë me mospërfitimin e pensionit të pleqërisë në masën e duhur dhe përlllogaritje të gabuar, sipas tij, nga ana e subjektit ndaj të cilit është ankuar (DRSSH Shkodër).

Nga aktet e depozituara pranë KMD-së, evidentohet se, ankuesi nuk ka ndjekur rrugën e shterimit të ankimit administrativ fillimisht, që më pas të mund ta bëjë objekt të shqyrtimit gjyqësor, sipas përcaktimeve të nenit 86, të ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar.

Komisioneri vlerëson se, rimarrja në shqyrtim e vendimeve të këtyre organeve (Dega Përfitimeve, DRSSH Shkodër, Komisione Rajonale të Ankimit, pranë DRSSH apo Komisione Qendrore të Ankimit, pranë ISSH) nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Komisioneri vlerëson se ky është një pretendim që trajtohet nga organet gjyqësore dhe jo nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

⁵ Për analogji citojmë vendimin nr. 235, datë 10.12.2021, vendimin nr. 239, datë 09.09.2024, vendimin nr. 12, datë 19.01.2026, vendimin nr. 27, datë 10.02.2026, të KMD-së.

Së fundmi: Lidhur me pretendimin për moskthimin e përgjigjes apo mosmarrjes së dokumentave/librezës së punës, nga ISHSH.

Ky kërkim i z. E. B nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj nga KMD, pasi Komisioneri vëren se, ky kërkim i ankuesit ka të bëjë me moszbatimin apo shkeljet e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, sa i takon pretendimit të tij për mosdhënie të dokumentacionit të kërkuar (librezës së punës) në mënyrë të përsëritur..

Për rrjedhojë, për sa më sipër, ankuesi mund t'i drejtohet institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi hetimi sa më sipër nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së⁶.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/dh, dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 50 Regj., datë 17.02.2026, të subjektit ankues E. B, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁶ Për analogji citojmë vendimin nr. 167, datë 22.08.2022 dhe vendimin nr.175, datë 05.08.2025, të KMD-së.